

HULUMTIM MBI DREJTËSINË SOCIALE

Hyrje dhe metodologjia e hulumtimit

Ky hulumtim është pjesë e aktiviteteve në aspekt të përcaktimit, njohjes dhe promovimit të nocionit ***drejtësi sociale***. Krahas këtij hulumtimi aktivitetet përfshijnë punëtori me qytetarë, sesione dhe takime me ekspertë/përfaqësues të institucioneve të ndryshme të cilët gjatë punës së tyre mund të detektojnë një padrejtësi sociale, përgatitje të materialeve promovuese dhe informuese lidhur me drejtësinë sociale dhe të ngjashme. Rezultatet e këtij hulumtimi bashkë me të gjitha aktivitetet e lartëpërmendura si një tërësi, do të përdoren për hartimin e një raporti final më të detajuar në periudhën që pason.

- ***Qëllimi i këtij hulumtimi është të përcaktohet/en se ku (pa)drejtësia sociale është më e përhapur.***

Për të arritur në të dhëna të cilat do mundësojnë në arritjen e qëllimit të hulumtimit, është konstruktuar një metodologji hulumtuese e cila do të garantonte vlefshmërinë e hulumtimit. Nevoja për të matur njohuritë/opinionet bazë mbi drejtësinë sociale në sfera të ndryshme, si dhe marrja e ideve mbi temat të cilat do të përpunohen në një punëtori/workshop në të ardhmen, paraqitet si kusht për një hulumtim të mirë organizuar.

Organizimi i metodologjisë së hulumtimit përmes grumbullimit dhe analizës së të dhënave ka për qëllim shpjegimin sa më të mirë të ***Drejtësisë Sociale***. Në këtë rast kemi implementuar metodën e anketimit si formë më e përshtatshme për mbledhjen e të dhënave.

Për të arritur në të dhëna të cilat do të ofrojnë një shpjegim rreth drejtësisë sociale, është zgjedhur metoda e anketimit si metodë më e përshtatshme, respektivisht pyetësori i përbërë nga pyetja të mbyllura me një zgjedhje, pyetje të mbyllura me shumë zgjedhje, shkallë të Likertit dhe pyetje të hapura. Mostra (zgjedhja) është paraprakisht e përcaktuar, ku pjesë e këtij hulumtimi do të jenë përfaqësues në institucione arsimore (staf pedagogjik dhe administrativ), OJQ, komunë, Enti për punë sociale dhe ngjashëm.


Për të interpretuar të dhënat do të përdoret statistika përshkruese. Rezultatet e fituara do të paraqesin bazë për diskutim në një punëtori (workshop) gjatë muajve të ardhshëm, dhe në bashkëveprim me aktivitete tjera lidhur me temën do të rezultojnë në një raport final më të detajuar.

Prezantimi dhe interpretimi i të dhënave

Gjithë përfshirja paraqet një parakusht që të gjithë palët ku drejtësia sociale duhet të jetë më e theksuar, duhet të jenë të përfshira në këtë hulumtim. Në fillim do të paraqesim dy grafikone me të dhëna demografike të të anketuarve, me qëllim të krijimit të një profili të plotë demografik. Pyetjet janë të orientuara në vendin e punës dhe përvojës në punë.


Grafiku 1 paraqet të dhënat demografike të vendit të punës të të anketuarve. Vërehet, se shumica e pjesëmarrësve në këtë hulumtim janë të punësuar në institucion edukativo-arsimor, si staf pedagogjik, staf administrativ si administratë, pedagog i shkollës, defektolog e ngjajshëm me rreth 64%, duke u ndjekur pas me rreth 14% të respondentëve të punësuar në Entin për punë sociale, dhe me përqindje të barabartë prej rreth 7% të punësuar në komunë, pra ne krijimin e politikave sociale në nivel lokal, në organizata joqevritare, që paraqiten edhe si lobues më të mëdhenj të padrejtësisë sociale dhe institucione/organizata të tjera të cilat nuk janë të parapara në përgjigjet e dhëna.

Grafiku 1. Puna/vendi i punës i të anketuarve



Përvoja në punë, së bashku me njohuritë/ekspertizën, ju mundëson të punësuarve për të identifikuar, njohur drejtësinë sociale (respektivisht padrejtësinë e cila ndodh). Në këtë grup të respondentëve, 50% prej tyre ka një përvojë më të shumë se 8 vjet në punë, rreth 7% kanë një përvojë prej 5 – 8 vjet në punë, dhe pjesa tjetër paraqitet më përvojë pune më të ulët se 5 vjet.

Grafiku 2. Eksperienca e punës të respondentëve



Me qënë se, tek shpjegimi i metodologjive të hulumtimit, është theksuar se zgjedhja paraprakisht e përcaktuar, dhe duke u bazuar në dy grafiket e më sipërme, mund të themi se grupi i respondentëve të zgjedhur për nga profesioni dhe përvoja në punë, arrin standard të lartë, që rezultatet e fituara të jenë të besueshme dhe valide.

Në vijim do të paraqiten dhe interpretohen të dhëna në lidhje me drejtësinë sociale. Atë që e interpretojmë më lartë, pasqyrohet edhe në këtë grafik, pra rreth 64% të respondentëve e kanë hasur termin ***drejtësi sociale***, kundrejt 29% të cilëve nuk e kanë hasur këtë term gjatë punës së tyre, dhe pjesa tjetër e mbetur rreth 7% nuk preferojnë të japin përgjigje.

Grafiku 3. Sa shpesh e keni hasur termin ***drejtësi sociale*** në punë




Drejtësia sociale mund të interpretohet në fusha të ndryshme. Në këtë hulumtim si të tillë e kemi përfshirë në të drejtat e njeriut, të drejtat dhe mundësitë ekonomike, mirëqenia sociale, liria dhe barazia, dhe drejtësia. Për të matur dhe vlerësuar më mirë secilën deklaratë, është përzgjedhur shkalla e Likertit, duke ranguar secilën deklaratë me shkallën 1 ose aspak të rëndësishme dhe shkallën 5 shumë të rëndësishme. Duke u bazuar në grafikun e më poshtëm, si e përzgjedhur shumë e rëndësishme me 83% është ***barazia dhe drejtësia***. Barazia këtu

përfshin barazinë e shpërndarjes së resurseve ekonomike (ku jo rastësisht Maqedonia e Veriut ka Koeficientin Gini më të lartë, koeficient i cili shpreh pabarazinë në shpërndarjen e të ardhurave), barazia gjinore, barazia në qasjen e resurseve të tjera e ngjajshëm. Si deklaratë e dytë e ranguar është **mirëqenia sociale** me 81%. Mirëqenia e një vendi varet nga mirëqenia e shtresës më të varfër të saj, dhe tek kjo shtresë paraqitet jo-barazia, jo-drejtësia, mungesa e qasjes në resurse të ndryshme etj. Deklaratë e tretë e ranguar nga të anketuarit janë **mundësitë ekonomike** me 75%, pra qasja na resurse ekonomike, punë, të ardhura të tjera e ngjajshëm. Si të fundit të ranguara janë deklaratat **Liria** dhe **Të drejtat**. Edhe pse Liritë dhe të Drejtat paraqiten si fundamentale, në një vend me zhvillim ekonomik të ulët, korrupsion, probleme në fushën e arsimit, **Liritë dhe Të Drejtat** shihen si diçka e cila nuk është më e rëndësishme se sa mirëqenia, të ardhurat, barazia etj.

Rezultate të detajuara janë të dhëna ne grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 4. Vlerësimi i deklaratave përbërëse të Drejtësisë Sociale



Në aspekt të rangimit se ku shfaqet padrejtësia sociale më shumë, është bërë ky klasifikim:

#	Rangimi / Рангирање	
1	Shkollimi/Edukimi / Образование	33.33%
2	Mbrojtja sociale / Социјална заштита	33.33%
3	Shëndetësi / Здравstvo	26.67%
4	Të drejtat ekonomike / Економските права	6.67%
5	Tjetër / Друго	0.00%


Në bazë të përgjigjeve të fituara padrejtësia sociale më se shumti shfaqet në sektorin e arsimit dhe mbrojtjes sociale me 33.33%, duke u pasuar me 26% në shëndetësi dhe kështu me rradhë. Disa nga arsyetimet dhe vlerësimet e të anketuarve mbi këtë rangim janë si në vijim:

(për të mos cënuar domethënien e tyre, arsyetimet e dhëna aspak nuk janë edituar)

- *Mbrojtja sociale ka një rëndësi të madhe për mbrojtjen e qytetarëve të cilët kanë standard më të ulët ekonomik*
- *Rëndësi më të madhe ka mbrojtja sociale, pastaj vjen sistemi shëndetësor i cili është shumë i rëndësishëm*
- *Arsimimi llogaritet si boshti kurrizor i shoqërisë; Shëndetësia e dyta si domosdoshmëri e pakontestueshme për shoqërinë; Mbrojtja sociale si domosdoshmëri për shoqërinë tonë; Të drejtat ekonomike dhe mirëqenia ekonomike përcakton vetëdijen e njeriut.*
- *Nga të drejtat ekonomike varet mirëqenia e një individi në shoqëri, ashtu që të gjitha fushat tjera nuk i ofrojnë shërbimet dhe privilegjet e njëjta për të gjithë qytetarët nëse siguria e tyre ekonomike është e ulët.*
- *Mbrojtja sociale është faktor kyç në zhvillimin e shëndetit fizik dhe mendor të individit.*

Arsyetimet e dhëna, mbështesin rangimin e mësipërm. Vlen të theksohet se 100% e respondentëve janë të opinionit se individët nuk trajtohen në mënyrë të barabartë në shoqëri.

Grafiku 5. Trajtimi i barabartë i individëve




Dhe, është e rëndësishme të theksohet se të gjithë do të ishin të gatshëm të marrin pjesë në afirmimin dhe promovimin e drejtësisë sociale. Nga metodat që më së shumti do t'i përdorin ose aplikojnë për promovimin e drejtësisë sociale janë si në vijim:

- 50% do të ndërmarrin veprime pozitive në komunitet, në aspekt të punës, përvojës dhe ekspertizës së tyre,

- Rreth 36% do të përkrahin aktivistët të cilët luftojnë për drejtësi sociale dhe,
- Rreth 14% do të tentojnë të përfshihen në vendime politike, në krijimin e politikave lokale të cilat do të pasqyronin dhe drejtësinë sociale në to.
- Vullnetarizmi nuk është përzgjedhur aspak nga të anketuarit, por shumica e tyre janë të gatshëm të marrin pjesë në një punëtori rreth drejtësisë sociale.

(shpjegim: si përgjigje respondentët kanë mundur të zgjedhin vetëm një alternativë të vetme)

Grafiku 6. Metodatat e promovimit të drejtësisë sociale



Volunterizmin / Волонтирање

Ndërmarrja e veprimeve/aksioneve pozitive në komunitet / Преземање позитивни акции во заедницата

Përfshirja në vendimmarrje politike nëpërmjet angazhimin civil (sektorit civil) / Вклучување во политичките одлуки преку граѓански ангажман (граѓански сектор)

Përkrahja e aktivistëve (dhe personave të tjerë) të cilët ngrejnë zërin rreth pa-drejtësisë / Поддршка на активисти (и други) кои zburуваат за неправда

Nuk besoj se do të mar pjesë në promovim të drejtësisë sociale në një nga format e lartpërmendura / Не верувам дека ќе учествувам во промовирањето на социјалната правда со некоја од горенаведените форми

Dhe, së fundmi më poshtë janë të paraqitura disa nga opinionet e tyre rreth definimit të drejtësisë sociale, dhe atë:

Si do ta kishit definuar drejtësinë sociale / Како би ја дефинирале социјалната правда?

- Barazi dhe rritje të mirëqënies të shtresës sociale

- Drejtësi dhe barazi në shpërndarje të resurseve, të drejtave dhe ngjajshëm

- Barazia e njerëzve dhe solidariteti kolektiv si synim për një shoqëri përparimtare

- Drejtësinë sociale do ta kisha definuar si një të drejtë të pakontestueshme ku njerëzit do të ndiheshin të pa diskriminuar nga shtresa që përpiqet çdoherë të jetë dominante me të padrejtë në shoqëri.

- Njëfarloj mënyre e drejtë e ndarjes së resurseve, privilegjeve, mundësive në një shoqëri

- Drejtësia sociale ka të bëjë me barazinë dhe trajnimin e të gjithë personave në formë të njëjtë pa marr parasysh racën, gjininë, fenë, kombësinë, etj.

- Drejtësia sociale është një koncept moral dhe politik që synon barazinë e të drejtave mes njerëzve dhe solidaritetin kolektiv.

- Qasje në resurse, barazi dhe drejtësi.

Përfundime dhe angazhime në të ardhmen

Nga ky hulumtim janë grumbulluar dhe fituar informacione të rëndësishme në kuptimin e perceptimit të termit ***drejtësi sociale***, ku më së shumti ajo shfaqet (është mangësi) dhe sa kanë njohuri respondentët rreth këti fenomeni. Qëllimi i hulumtimit ishte përcaktimi i dy pikave kryesore të cilat do të trajtohen rreth drejtësisë sociale në një workshop dhe atë:

- ***Drejtësia sociale në arsim dhe,***
- ***Drejtësia sociale dhe mirëqenia sociale.***